



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:013970

Datë: 28.01.2025

Numri i dokumentit: 06765536

KPPP.nr. 1764/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Astraplan” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 70464863 dhe seli në Prishtinë, Kodra e Diellit, rr. “M. Gradica”, H. 5/6, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Salihu, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kuvendi Komunal i Mitrovicës, me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isuf Zejna, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 585/22, të lejuar me datë 06.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kuvendi Komunal i Mitrovicës ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 585/22, i lejuar me datë 06.10.2022 nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Astraplan” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 11/2022 e datës 06.09.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 585/22 të datës 06.10.2022, me të cilin është urdhëruar debitori Kuvendi Komunal i Mitrovicës që në afat prej shtatë (7) ditësh, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej EUR 351,394.79 (*treqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër Euro e shtatëdhjetë e nëntë Cent*), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është urdhri përmbarimor nuk është nënshkruar dhe vulosur nga debitori, nuk figuron në listën e obligimeve dhe punët sipas së njëjtës nuk janë autorizuar nga menaxheri i kontratës apo organi mbikëqyrës, andaj fatura nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Më tej, ka shtuar se të gjitha obligimet janë përmbushur ndaj kreditorit dhe se debitori nuk ka asnjë borxh të pa paguar, andaj edhe borxhi i pretenduar me propozimin për përmbarim është fiktiv. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të paguajë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri përmbarimor është lejuar në bazë të faturës si dokument i besueshëm. Më tej, ka theksuar se prapësimi i debitorit është i jashtë afatshëm pasi që prapësimin e ka paraqitur me datë 24.10.2022 përmes postës me numër rekomande R2589269, e po ashtu dëshmohet edhe nga komunikimi elektronik i datës 13.10.2022 në mes të zyrtarëve të debitorit i cili ka kërkuar informacione nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Financa dhe Zhvillim Ekonomik përkitazi me faturat e pa paguara që kanë të bëjnë me propozimin për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që urdhri përmbarimor të hedhet poshtë si i pa lejuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP.nr. 2364/22 të datës 29.12.2023, e ka hedhë poshtë prapësimin e debitorit si të pa afatshëm.

Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë në gjykatën e shkallës së dytë. Ndërsa, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 615/24, të datës 13.12.2024, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit dhe e ka prishë Aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 2364/22, të datës 29.12.2023, ndërsa lëndën i'a ka kthyer të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Gjykata, në ri-procedurë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i marrë për bazë edhe vërejtjet e Dhomave të Shkallës së Dytë të dhëna në aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 615/24 të datës 13.12.2024, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata në rastin konkret gjeti se dokumenti Faturë nr. 11/2022 e datës 06.09.2022 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi ndaj debitorit, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument

i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së për faktin se fatura e lartcekur, nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, qoftë përmes vulës së pranimit të shkresave të debitorit si institucion publik apo pranimit të faturës nga personi përgjegjës i debitorit, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori.

Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme i'a ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës. Rrjedhimisht, fatura si e tillë rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilës Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e kreditorit lidhur me atë se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm mirëpo gjeti se përmes parashtrësës së datës 01.11.2022, Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha e ka dorëzuar fletë kthesën për dorëzim personal nga Posta e Kosovës, nga e cila rezulton se debitori ka pranuar urdhrin përmbartimor me datë 18.10.2022, ndërsa që nga shkresat e lëndës vërtetohet se debitori përmes postës rekomande, me datë 24.10.2022 ka paraqitur prapësimin ndaj këtij urdhri, fakt ky i cili vërtetohet nga zarfi i postës me numër R 2589269.

Andaj, duke marrë për bazë edhe sugjerimet e Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate të dhëna në aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 615/24 të datës 13.12.2024 si dhe pas vlerësimit të provave të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i ushtruar nga debitori është ushtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor, kjo në mbështetje të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore ku përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues.”*

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1764/24, datë 28.01.2025

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.